

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE DURRES
ZYRA NOTERIALE ELBASAN
NR.REP 4400 NR. KOL 1623

NOTERE
Ornela H. Guranjaku
L. : "Aqif Pasha", ELBASAN
Tel 069 75 11 079

**KONTRATE PER LIKUIDIM KUOTASH ME ANË TË SHITBLERJES
ME KUSHT DHE ME REZERVE
(Pasuri e luajtshme)**

Sot me date 20 shtator (dymije e shtatëmbëdhjetë), diten e Ejte , ne palët e mëposhtme kontraktuese, hartojmë këtë kontratë likuidim kapitali nga shoqeria Blerimi sh.p.k ne favor te ortakut Nazif Allani si më poshtë vijon.

PALET E PERFSHIRA NE KONTRATE

Ortaku Nazif Allani , atesia Mustafa lindur me 15.10.1951, ne Belsh dhe banues në Elbasan, lagjia „ Sul Paprri“ Rruga Ismail Xhaja Vila Nr 1803, madhor , me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtes e leternjoftimit me nr.personal: **F11015002H**

Ortaku Behexhet Uruci atesia Nexhip , lindur më , 28.08.1954, në Belsh Elbasan dhe banues ne Elbasan,lagja „Kongresi Elbasanit: Rruga „Ismail dhe Xhemali Debrova“ Pall.51/3 Shk,1 k.9 Ap.34 madhor , me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtes e leternjoftimit me nr.personal:**F40828104I**.

Ortaku Besmir Uruci atesia Behexhet , lindur më, 09.11.1987, në Elbasan dhe banues ne Elbasan, Kongresi Elbasanit: Rruga „Ismail dhe Xhemali Debrova“ Pall.51/3 Shk,1 k.9 Ap.30, madhor , me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtes e leternjoftimit me nr.personal:**I71109058D**

madhare me zotesi te plete juridike per te vepruar te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe te plete me kerkuan Mua Noteres hartimin e kesaj kontrate (KONTRATE PER LIKUIDIM KUOTASH ME ANË TË SHITBLERJES ME KUSHT DHE ME REZERVE (Pasuri e luajtshme))

KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE PARAPRAKE

Shoqëria është e regjistruar pranë QKB-së si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me NIPT J62903384G, me objekt kryesor të sajin Ndertime civile dhe industriale, turistike, projekte, prodhim materiale ndertimi, import-eksport, tregti me shumice dhe pakice dhe transporte te ndryshme. Transport mallrash e udhetarësh, punime duroalumini, druri, hekuri, tregtim me pakice te karburantit, pjese kembimi per automjete, krijimi i agjensive turistike, udhetimi dhe reklame etj.

Vlera e kapitalit të shoqërisë është 125 000 000 (njëqind e njëzetë e pesë milion lekë).

Ortaku Nazif Allani është zotëruesh i 50% të kuotave, në total **1 (nje) pjesë**, me vlerë totale prej **62 500 000, (gjashtëdhjetë e dy million e pesëqind mijë) lekë**, në shoqërinë Blerimi shpk, që këtu e më poshtë referuar si shoqëria.

Ortaku Nazif Allani ka shprehur vullnetin e tij të lirë edhe të plotë të largohet nga shoqeria Blerimi sh.p.k dhe të shesë kuotat e veta, që nga momenti i nënshkrimit të vendimit te asamblese Nr.13 date 04 korrik 2017, të mos ketë asnje përfitim financiar nga shoqëria, apo nga beneficiet që sjell pozicioni i ortakut.

Me hartimin e kësaj kontrate, ortaku Nazif Allani detyrohet të mos angazhohet në asnje aktivitet të mëpasshëm të shoqërisë dhe të mos kërkojë asnjëloj përfitimi që buron prej ushtrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë per kontratat e lidhura nga shoqeria pas dates 04 korrik 2017.

Ortaku Nazif Allani kerkon nga Shoqeria likuidimin e të gjitha kuotave te veta dhe pas realizimit të kushtit të likuidimit të perqindjes se pjesemarrjes ne shoqeri ai nuk është më ortak i shoqërisë.

Pas realizimit të likuidimit te vleres 62 500 000, (gjashtëdhjetë e dy million e pesëqind mijë) lekë ortakut Nazif Allani, kapitali i shoqerise mbetet i njëjtë 125 000 000 (njëqind e njëzetë e pesë milion lekë) dhe behen keto ndryshime ne kapitalin e ortakeve:

Ortaku Behexhet Uruçi, vlera e kapitalit ishte 37 500 000 (tridhjete shtate milion e peseqind mijë) leke , behet 75 000 000 (bëhet shtatëdhjetë e pesë milion lekë), numri i pjeseve 1, pjesemarrja ne perqindje 60%.

Ortaku Besmir Uruçi, vlera e kapitalit ishte 25 000 000 (njezet e pese milion) leke, behet 50.000 000 (pesëdhjetë milion lekë), numri i pjeseve 1, pjesemarrja ne perqindje 40%.

Ky ndryshim do te reflektohet rast pas rasti sipas shumes se likujduar dhe pas depozitimit ne QKB te Formularit te Urdher Transfertes per likujdim kuotash nga shoqeria Blerimi ne favor te ortakut Nazif Allani.

Duke qënë se Ortaku /shitësi e ka të pamunduar të qëndrojë aktiv dhe në tregun e punës në shoqëri per arsyeshendetësore , referuar kerkeses se tij, e duke mos gjeneruar përfitime për shoqërinë për një kohë të gjatë, vlerëson të ofrojë për shitje kuotat e veta, sipas mënyrave të parashikuara në këtë kontratë, dhe të heqë dorë përfundimisht nga veprimitaria tregtare e ardhshme e shoqërisë.

Në këto kushte, në përputhje me, "Mënyrën e fitimit dhe të kalimit të kuotave" sipas ligjit 9901 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, neni 705 e vijues i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, , hartohet kjo kontratë per likuidim kuotash me anë të shitblerjes si më poshtë vijon:

NENI 1

Objekti i Kontratës:

Në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, ortaku Nazif Allani pas likuidimit te kuotave te tij, me anë të shitblerjes , zhvishet nga pronësia ne kete shoqeri dhe pronesia i kalon ortakeve Behexhet Uruçi dhe Besmir Uruçi ne vleren totale 100% te kapitalit te shoqerise. Me kalimin e kuotave kalohet e drejta e pronësisë si dhe të gjitha të drejtat e tjera të lidhura me kete pjesëmarrje tek ortaket Behexhet Uruçi dhe Besmir Uruçi, duke i garantuar plotësisht ortaket Behexhet Uruçi dhe Besmir Uruçi mbi titullin e pronësisë të pa

ngarkuar me barrë. Ortaket Behexhet Uruçi dhe Besmir Uruçi nga ana tjetër perfitojne kuotat sipas vlerës dhe mënyrave të përcaktuara në këtë kontratë.

NENI 2

Afati:

Palët kontraktuese nuk përcaktojnë afat për kohën e realizimit përfundimtar të transaksionit. Likujdimi do të bëhet gradualisht, në një afat kohor të papërcaktuar i cili kushtezohet nga likuiditetet qe do te hyjne ne llogarine e shoqerise ne banken BKT Dega Elbasan llogari nr.405102008 nga kontratat e lidhura deri me dt.03 korrik 2017 dhe te perfunduara deri me date 30 gusht 2017 te cilat rezultojne te palikujduara.

Per çdo likujdim qe do te perfitoje ortaku Nazif Allani do te bej pagesen e pjeses perkatese te dividentit sipas legjislacionit ne fuqi ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate.

Neni 3

Vlera e likuidimit:

Vlera e likuidimit te kuotave të ortakut Nazif Allani është **62 500 000 (gjashtëdhjetë e dy million e pesëqind mijë) lekë .**

Kjo vlere është e pa çliruar nga taksat dhe tatimet e aplikuara në vlerën e kuotave. Per çdo likujdim qe do te perfitoje ortaku Nazif Allani do te bej pagesen e pjeses perkatese te dividentit sipas legjislacionit ne fuqi ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate. Vlera takuese e dividentit per kuotat e ortakut Nazif Allani sipas rakordimeve midis ortakeve eshte **7 824 733 lek (Shtate milion e teteqind e njezet e kater mijë e shtateqind e tridhjet e tre) Lek** i cili do ti zbritet vleres se likuidimit ne raport te drejte me të per çdo likujdim.

Vlera e likuidimit te kuotave të ortakut Nazif Allani pas çlirimt nga dividenti mbetet **54 675 267 (Persedhjet e kater milion e gjashteqind e shtatedhjet e pese mijë e dyqind e gjashtedhjet e shtate) lekë .**

Kjo vlere është e pandryshueshme dhe kuotat e ortakut Nazif Allani nuk mund të rivleresohen asnjëherë pas nenshkrimit te kësaj kontrate.

NENI 4

Menyra e pageses:

Pagesa e kuotave do të bëhet me këste nga shoqeria Blerimi sh.p.k në një afat të papërcaktuar kohor.

Shuma e kësteve do të varet nga hyrjet e të ardhurave në llogaritë bankare rrjedhese të shoqërisë ne banken BKT Dega Elbasan me llogari nr.405102008.

Ortakët e tjerë dhe administratori i shoqërisë kanë të drejtë të vlerësojnë sa do të jetë kësti i radhës për tu paguar, duke mare ne konsiderate hyrjen e radhes ne llogarine e mesiperme.

Likuidimi i kuotave të shitësit Nazif Allani do të bëhet nga të ardhurat e shoqërisë duke qënë momentalisht e pamundur që vlera e kuotave të shlyhet personalisht nga ortakët.

Ky vendim kushtëzohet nga kërkesa e ortakut Nazif Allani datë 25 qershor, ku në referim të sâj dhe nenit 101 të ligjit 9901 'Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare' në lidhje me likuidimin e kuotave.

NENI 5

Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat:

Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat nga ortaku Nazif Allani tek ortaket Behexhet Uruçi dhe Besmir Uruçi nuk do të bëhet menjëherë por ne menyre progresive sipas likujdimeve te kuotave, vërtetuar kjo me mandat pagesat përkatëse bankare.

Ky ndryshim do te reflektohet rast pas rasti sipas shumes se likujduar dhe pas depozitimit ne QKB te Formularit te Urdher Transfertes per likujdim kuotash nga shoqeria Blerimi ne favor te ortakut Nazif Allani dhe pas likujtimit te kestit te perfundimtar, kushti dhe rezerva do te konsiderohet e shuar duke u pasqyruar ne QKB.

NENI 6

Ekskluziviteti:

Ortaku Nazif Allani do të ketë cilësinë e ortakut me kufizimet e mospjesmarries në veprimtarinë e ardhshme të biznesit, në asnjë lloj përfitimi te metejshem pas dates 04 korrik 2017.

Ortaku Nazif Allani do te kete cilesine e ortakut dhe te administrimit se bashku me administratorin e shoqerise te llogarise rrjedhese te shoqerise prane Bankes BKT Dega Elbasan me llogari Nr.405102008 per shperndarjen e likuiditeteve qe do te hyne ne llogarine e shoqerise per kontratat e palikujduara te lidhura deri date 03 korrik 2017 dhe te perfunduara deri me date 30 gusht 2017. Shperndarja e likuiditetit do te behet ne menyre te tille qe 50% e tij do ti transferohet ortakut Nazif Allani per likuidimin e kuotave te tij ndersa 50% do te transferohet ne një llogari të re te shoqerise per vazhdimin e aktivitetit.

Ortaku Nazif Allani në cilësinë e ortakut ne largim bie dakord dhe angazhohet të respektojë këtë kontratë përgjatë gjithë kohëzgjatjes së veprimtarisë së shoqërisë.

Nuk lejohet ofrimi për shitje i pjesës së kapitalit të ortakut Nazif Allani, ngarkimi me barrë i kuotave, lënia peng e tyre në asnjë lloj forme dhe për asnjë arsy, përvencse tek ortaket Behexhet Uruçi dhe Besmir Uruçi.

NENI 7

GARANCITË

Ortaku Nazif Allani, në lidhje me kuotat që zotëron garanton ortaket Behexhet Uruçi dhe Besmir Uruçi:

- Se është pronar i vetëm i kuotave të likuiduara dhe nuk ekzistojnë të drejta parablerje, blerjes apo të marrjes së ndonjë personi të tretë në lidhje me kuotat e likuiduara.
- Se pagesa e dividentit mbi kuotat e likuiduara deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate do të përllogaritet dhe zbritet nga shuma e likuidimit.
- Të gjitha të mirat ekonomike të përdorura nga shoqëria, të cilat janë të nevojshme ose të dobishme për zhvillimin e aktivitetit ekonomik të shoqërisë dhe për vazhdimin e pakufizuar të tyre, pas datës së lidhjes së kontratës së likuidimit të kuotave, vecanërisht objektet pasurore, të luajtshme apo të paluajtshme, janë në pronën e vetme të shoqërisë dhe nuk janë ngarkuar me të drejta ose pretendime të të tretëve.
- Se ortaku Nazif Allani do të zhvishet tërësisht nga pronësia mbi pasuritë e përbashkëta të shoqërisë, pasi ato janë të përllogaritura në vlerën e kuotave të likuiduara.

Neni 8

REGJISTRIMI I KONTRATËS

Palët deklarojnë se janë dakord që kjo kontratë të regjistrohet pranë QKR-së si dhe regjistrat të aksioneve, brenda 30 ditëve nga momenti i hartimit të saj, duke krijuar kështu një dokument ligjor të plotë dhe duke shprehur vullnetin e realizimit të efekteve të veta.

NENI 9

TË NDRYSHME

Kjo Kontratë hartoher bazuar në dispozitat ligjore të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë trgtare" i ndryshuar. Ligji nr. 9723 dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar, dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim cdo mosmarrëveshje që rrjedh nga kjo kontratë. Në rast të kundërt gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kjo kontratë hartoher në 6 (gjashte) Kopje, me vlerë të njëjtë ligjore.

PALËT KONTRAKTUESE.

ORTAKET

NAZIF ALLANI

BEHEXHET URUÇI

BESMIR URUÇI